



RAPORT TREMUJOR : JANAR – MARS 2025

I. Hyrje

Gjatë periudhës tremujore Janar–Mars 2025, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) në Rahovec ka realizuar një sërë aktiviteteve të rëndësishme që kanë kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës për komunitetet jo-shumicë, fuqizimin e kthimit të qëndrueshëm dhe promovimin e të drejtave të njериut. Ky raport paraqet një përmbledhje të aktiviteteve dhe iniciativave të ndërmarra gjatë kësaj periudhe.

II. KOMPONENTËT E ZBATIMIT

1. Arsimit

- Në bashkëfinancim me IOM Kosovë, ka filluar iniciimi për mbështetjen e Shkollës Filllore të mesme të ulët “4 Dëshmorët” në fshatin Ratkoc me pajisje për kabinetin e fizikës, kimisë dhe biologjisë.
Kjo ndërhyrje mbështet fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, të cilët përbëjnë një përqindje të lartë të popullsisë së këtij lokaliteti.

2. Infrastruktura

- Fshati Iloçë e Madhe** – është inicuar shpallja për renovimin e infrastrukturës me fokus të komuniteti serb.
- Fshati Krusha e Madhe** – është inicuar projekti për renovimin e rrugës kryesore në zonat ku banojnë komunitete të përziera.
- Është inicuar një zgjidhje për qasjen në kanalizim për znj. Shutaković D .(mbështetur nga Drejtoriat e Shërbimeve Publike).
- ZKKK ka përgatitur një kërkesë zyrtare për KEDS-in, si dhe ka inicuar një peticion me pjesëmarrjen e komuniteteve në Lagjen e Epërme, me qëllim forcimin e kapaciteteve të furnizimit me energji elektrike në këtë zonë, përmes mundësisë së vendosjes së një trafostacioni të ri.

3. Përfaqësim institucional dhe koordinim ndërkomunal

- **Është themeluar Kolegjiumi i 24-të për Komunitete dhe Kthim**, në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës. Kryesimin e këtij kolegjiumi do ta bëjë z. **Lendrit Qeli**, Shef i ZKKK-së në Rahovec.
- Janë realizuar takime mes zyrtarëve të ZKKK-së dhe përfaqësuesve të GIZ-it gjerman, KFOR-it austriak dhe partnerëve tjerë institucionalë.

4. Aktivitete ndërgjegjëse dhe trajnime

- Mbajtja e mbledhjes së Mekanizmit Komunal Koordinues kundër Dhunës në Familje – Rahovec.
- Punëtori për zhvillimin e Planit të Veprimit kundër dhunës në familje me të njëjtin mekanizëm.
- Punëtori “Kthimi dhe riintegrimi i qëndrueshëm për të kthyerit nga Gjermania në Kosovë”, financuar nga Fondi për Azil, Migrim dhe Integrim (AMIF).
- Trajnim për Të drejtat e Komuniteteve në Kosovë, organizuar nga IKAP.
- Sesioni informativ rajonal dhe prezantimi i Platformës së Zyrës për Çështjet e Komuniteteve.
- Hulumtim mbi praktikën e punësimit gjithëpërfshirës – pjesëmarrje aktive.
- Edukimi i votuesve / Drejtësi Tranzicionale – pjesëmarrje në sesione informuese.
- Lansimi i fushatës “DU” – me fokus në vetëdijësim.
- Trajnim: “Strategjia për Drejtësinë Tranzicionale: Si të vazhdojmë përpara?”
- Ekspozita “TESTAMENT” – përfshirje në hapje dhe përcjellje të aktivitetit.
- “Roma Integration III – Green Transition and Green Agenda” – trajnime dhe diskutime për përfshirjen e komuniteteve në agjenda mjedisore.
- Takimi i Grupit Këshillues në Komunitet i organizuar nga OIQ-ROMA IN ACTION.

5. Angazhimi në takime dhe raporte

- Pjesëmarrja në dy mbledhje të Këshillit për Siguri në Bashkësi (KKS) – prezantim dhe kontribut në diskutime.
- Një mbledhje e Komitetit për Komunitete – është realizuar raportimi i aktiviteteve për vitin 2024 dhe plani për vitin 2025.
- Pjesëmarrja në takimi i parë me punëtorët e administratës komunale – informim dhe koordinim.
- Raportim mbi zbatimin e Programit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (2021–2025).
- Vlerësim i performancës së punëtorëve të ZKKK-së.

07/04/2025

6. Të tjerë

- ZKKK ka trajtuar dhe procesuar një numër të konsiderueshëm të kërkesave për riatdhesim dhe mbështetje për të kthyerit, duke ndihmuar integrimin e tyre të qëndrueshëm.
- Është shpërndarë dhe plotësuar një pyetësor për barazi gjinore në administratën publike, me qëllim të identifikimit të sfidave dhe mundësive për përmirësim.

III. Konkluzion

ZKKK në Rahovec ka treguar angazhim të vazhdueshëm në luajtimin e rolit të saj si urë lidhëse mes komuniteteve dhe institucioneve. Me thellimin e bashkëpunimit institucional dhe zgjerimin e aktiviteteve në fushat kyçe, zyra vazhdon të kontribuojë në ndërtimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe të barabartë.

Dr. sc. Lendrit Q. L.

Shefi i ZKKK-së



07/04/2025